


“PRAKTIKËN PROFESSIONALE”

PERCEPTIMI I NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA NË LIDHJE ME



Këshilli i Nxënësve të Kosovës
Student Council of Kosovo

**SCHÜLER
HELPEN
LEBEN**

Raporti i hulumtimit

"Perceptimi i Nxënësve të shkollave të mesme të larta në lidhje me Praktikën Profesionale"

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Building a Generation of Impact through Student Council" me mbështetje të Schuler Helfen Leben (SHL) dhe implementuar nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC). Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

KYC

Prishtinë 10000, Kosovë

kyckosova@gmail.com

+383 (44) 96 45 75

Të drejtat e autorit © 2023. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Fq. 6

HYRJE

Faqe 8

METODOLOGJIA

Faqe 9

**ANALIZA E
SITUATËS**

Faqe 10

**ANALIZA E
TË DHËNAVE**

HYRJE

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është një nga organizatat më të vjetra jo-qeveritare rimore e themeluar në vitin 1999 në kampet e refugjatëve në Shqipëri, dhe e regjistruar zyrtarisht më vonë gjatë atij viti në Prishtinë, Kosovë. KYC aspiron të punojë drejt ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë përmes promovimit të iniciativës, mbështetjes së të rinjve, angazhimit të vajzave dhe djemve në proceset vendimmarrëse, fuqizimit të kapaciteteve të tyre, përfaqësimit të zërit rimore, promovimit të edukimit të vetë-organizuar dhe mbështetjen e zhvillimit të politikave rimore.

Rinia është në qendër të organizatës dhe e gjithë puna zhvillohet në bazë të këtyre kanaleve: stafit, vullnetarëve dhe strukturave përfaqësuese. Të rinjtë, pra, janë motori i organizatës me të cilët ne synojmë të rrisim cilësinë në arsim.

KYC bashkëpunon me institucionet arsimore, organizata jo-fitimprurëse, institucionet publike dhe institucionet tjetra, për të ruajtur një shkallë të lartë të mirëqenies, edukimit dhe aktivizimit të të rinjve në komunitetet e tyre. Ndër bashkëpunimet e shumëta, KYC është në partneritet me Fondacionin Gjerman - Schüler Helfen Leben (SHL) në projektin "Fuqizimi i Këshillit të Nxënësve të Kosovës (KNK)".

Këshilli i Nxënësve të Kosovës është struktura më e madhe nationale e përfaqësimit të zërit të nxënësve, me një përfshirje prej 106 shkollave të mesme të larta në 29 komuna të vendit, të cilat në bazë të Statutit të KNK-së, cdo vit zgjedhin Këshillin Drejtues të KNK-së (të përbërë nga përfaqësues nga secila komunë), organ i cili mblidhet rregullisht dhe koordinon aktivitetet e KNK-së.

KNK ka për qëllim përfaqësimin e mendimeve dhe nevojave të nxënësve, në tryeza institucionale, ngjarje avokuese dhe në takime vendim-marrëse, në nivel shkolle, nivel komunal apo nacional. Të organizojnë aktivitete të ndryshme në të mirë të nxënësve dhe të ndihmojnë në zhvillimin e cilësisë në arsim. Në mesin e aktiviteteve të shumëta për zhvillimin e cilësisë në arsim, është edhe aktiviteti i realizimit të hulumtimeve për të kuptuar më mirë situatën aktuale të edukimit para-universitar në Kosovë.

KYC në raportimet e mëhershme në lidhje me "Cilësinë në Arsim - Përceptimin e Nxënësve në lidhje me Përbajtjen, Procesin dhe Mjedisin mësimor", në 29 komuna të Kosovës (shumicë shqiptare, 2022), si dhe raportimeve të mëhershme në nivel Kosove (2010, 2016), ka kuptuar më shumë për perceptimin e nxënësve në lidhje me këtë çështje. Nëpërmjet këtyre raporteve, KYC ka ofruar rekomandime drejt politikave, iniciativave dhe aktiviteteve që duhet ndërmarrë për avancimin në edukim.

Së fundmi, duke parë nevojën për hulumtim drejt praktikës profesionale, është vlerësuar si i duhur realizimi i hulumtimit në lidhje me "Përceptimin e Nxënësve rreth Praktikës Profesionale".

METODOLOGJIA

Ky hulutim është realizuar për të kuptuar përceptimin e nxënësve të shkollave të mesme të larta të Kosovës rreth praktikës profesionale në kuadër të studimeve gjatë shkollës. Hulumtimi ka dizajn sasior, me ç'rast është përdorur pyetësori si bazë kryesore për mbledhjen e të dhënave. Ky pyetësor është realizuar nga Grupi i Hulumtimit, në kuadër të Këshillit të Nxënësve të Kosovës (KNK), në bashkëpunim me ekspertë të fushës, dhe është ri-shikuar edhe nga stafi i KYC. Pyetësori është ndarë përmes platformës online "Google Forms", gjatë periudhës Mars – Qershori, 2023, tek nënësit e shkollave të mesme të larta të Kosovës, për të evidentuar problematikat rreth praktikave shkollore dhe në këtë mënyrë është administruar, krejtësisht në formë anonime.

Pjetësori ka përfshirë disa dimensione, duke filluar prej pyetjeve demografike që janë kërkuar gjinia, mosha, klasa, rajoni ku jetojnë dhe shkolla ku vijojnë mësimet. Pastaj, pyetësori përfshiu dimensionin e mundësisë së mbajtjes së praktikës shkollore me pytje rreth mbajtjes së praktikës, ku kanë mbajtur praktikë, sa ka zgjatur, a ka qenë me pagesë, dhe sa janë ndarë të kënaqur me praktikën. Pjesë tjetër me rëndësi ishte edhe pjesa ku janë pyetur për interesimin e tyre në punë praktikë në vazhdimësi, pse janë të interesuar të mbajnë praktikë, sa është e dobishme praktika për ta. Dimension tjetër i pyetësorit ishte edhe interesimi i tyre për të mbajtur praktikë në biznese lokale, drejtimin që do kishin interes të mbanin praktikë, cilat janë sfidat gjatë pjesëmarrjes në një program që bashkon shkollat e mesme me biznese, si dhe sugjerimet që kanë për përmirësimin e programit të punës praktike në shkolla të mesme.

Në përgjithësi janë anketuar 563 nxënës të shkollave të mesme të larta, në 7 rajone të Kosovës. Rajoni i Prishtinës përfshiu 38.8%, Ferizaj 30.6%, Gjakovë 8.5%, Pejë 7.2%, Mitrovica 7.6%, Gjilan 5%, Prizren 2.3%. Prej numrit të përgjithshëm të respondentëve, 72.6% janë vajza, 24.2% janë djemë dhe 3% prej tyre kanë preferuar mos të përgjigjen. Ndërsa sa i përkët moshës së tyre, 32.3% - 17 vjeçar, 28.1% - 16 vjeçar, 20.8% - 15 vjeçar, 17.6% - 18 vjeçar, 0.5% - 19 vjeçar, 0.2% - 68 vjeçar, 0.2% - 24 vjeçar, 0.2% - 20 vjeçar, 0.2% - 25 vjeçar.

Administrimi i pyetësorit përmes formës online mund të cilësohet si limitim, përfaktin se administrimi online kufizon kontrollin e hulumtuesve mbi mënyrën se si respondentët kanë kuptuar përshkrimin e pyetjeve dhe mënyrën e plotësimit, dhe gjithashtu mund të ngritë shqetësimin rreth besueshmërisë së përgjigjeve.

ANALIZA E SITUATËS

Praktikat profesionale luajnë një rol thelbësor në rrugëtimin e nxënësve në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), duke u ofruar atyre një urë lidhëse ndërmjet mësimit në klasë dhe aplikimit të atyre njohurive në botën reale. Këto përvoja praktike u ofrojnë nxënësve mundësinë për të zbatuar njohuritë teorike në situata praktike, duke i lejuar ata të zhvillojnë aftësi të vlefshme në një mjedis profesional. Për nxënësit e shkollave profesionale, praktikat profesionale janë veçanërisht të rëndësishme pasi u mundësojnë atyre të fitojnë aftësi specifike për industrinë, të rrisin ekspertizën e tyre teknike dhe të kuptojnë operacionet e përditshme të fushës së tyre të zgjedhur. Për më tepër, praktikat janë jetike për të nxitur një tranzicion të pandërprerë nga arsimi në punësim. Shumë punëdhënës preferojnë të punësojnë kandidatë me përvojë praktike andaj praktikat u ofrojnë nxënësve një avantazh konkurruesh në tregun e punës. Këto përvoja jo vetëm që rritin rezymetë e tyre, por gjithashtu zhvillojnë besimin e tyre, duke i bërë ata më të përgatitur për mundësitë e ardhshme të punësimit.

Gjatë vitit 2022, KYC në bashkëpunim me KNK, ka lansuar raportin "Cilësia në Arsim", ku njëra nga temat e trajtuarë ka qenë edhe ndjenja e përgaditjes për tregun e punës. Përmes këtij hulumtimit, 35.5% e nxënësve kanë raportuar se nuk është aspak e vërtetë apo e pavërtetë deri diku deklarata se mësimet në shkollë i kanë përgatitur për tregun e punës. Për më tepër, edhe në raportin e performancës të zyrës së auditimit "Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës 2020", shtjellohet problemi në lidhje me pamundësinë për zhvillim të mjaftueshëm profesional të nxënësve në IAAP, ku ndër ariset kryesore janë edhe pamundësia e angazhimit të duhur dhe sistematik të nxënësve në praktika profesionale qoftë ajo në punëtoritë, kabinetet apo laboratorët e IAAP-ve apo në biznese të fushës. Si rrjedhojë, situata në lidhje me mundësitë e praktikës profesionale për nxënësit në IAAP mund të jetë sfiduese.


Marrë parasysh problematikat e mundësisë së kufizuar të realizimit të punës praktike për nxënësit e shkollave të mesme të larta, është vlerësuar i duhur realizimi i një hulumtimi të tillë. Nëpërmjet identifikimit të shqetësimeve dhe problematikave kryesore, mund të krijohet një bazë e fortë për ndryshim të kushteve dhe realizimit të bashkëpunimit më të mirë të shkollave me biznese.

ANALIZA E TË DHËNAVE

5. A keni mbajtur ndonjëherë punë praktike?

Si fillim, është parashtruar pyetja në lidhje me punën praktike. Në bazë të rezultateve, tek kjo pyetje, nga gjithësej 556 përgjigje, 60.4% prej tyre janë përgjigjur me po, do të thotë kanë mbajtur punë praktike, ndërsa 39.6% e tyre nuk kanë mbajtur punë praktike.

Shënim: Tek kjo pyetje, nëse përgjigja ishte po, do të përgjigjeshin edhe në pyetjen pasuese në lidhje me vendin ku kanë pasur mundësi të mbanin punë praktike.




Pyetja 5

5.1. Ku e keni mbajtur këtë praktikë?

Në bazë të rezultateve, përgjigjet më të shpeshta ishin: në barnatore, biznese private si: optika moda, dyqane të modës dhe stilit, furrë buke, hotele, në markete, në firma ndërtimore, sallon ondulimi, në fabrika ushqimore, në ordinancë stomatologjike, në televizion privat, pastaj në qendra të mjekësisë familjare, në spitale, në shkollë (përfshirë edhe shkollat e muzikës), në universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", në autosallon, në zyre të kontabilitetit, në post-telekom, në komunë - zyre ligjore, në drejtori të inspeksionit, Gjykatë Themelore, në stacion të autobusave, në qendrën e studentëve, dhe në ujësjellës të qytetit.


5.2. Sa ka qenë kohëzgjatja e programit të praktikës?

Çështje tjetër me rëndësi ishte edhe kohëzgjata e punës praktike. Nga rezultatet e fituara mund të shihet se nga totali i 556 respondentëve, 33.1% e tyre kanë mbajtur punë praktike 1 muaj, 15.1% prej tyre kanë mbajtur punë praktike 3 muaj, 31.2% kanë mbajtur 6 muaj, 20.6% prej tyre u përgjigjën me opsonin tjetër, dhe në këtë opson kanë shënuar kohëzgjatje të ndryshme, si 1 vit, 2 vite, 3 vite, gjatë një viti shkollor, si dhe përgjigjje të tjera më specifike.




5.3. A ka qenë praktikë me pagesë?

Nxënësit gjithashtu janë pyetur se a ka qenë puna praktike me pagesë, në 93.3% të rasteve nxënësit kanë raportuar se nuk ka qenë me pagesë, kurse në 6.1% të rasteve ata kanë mbajtur punë praktike me pagesë.



5.4. Sa jeni ndarë të kënaqur me këtë eksperiencë?


Dhe në fund të këtij dimensioni, nxënësit janë pyetur se sa kanë qenë të kënaqur, me mundësi në përgjigje si në vijim: 1 (Aspak i/e kënaqur) deri në 5 (Shumë i/e kënaqur). Nga rezultatet shihet se 28.1% e tyre e kanë vlerësuar me 1, 6.1% prej tyre e kanë vlerësuar me 2, 17.6% e nxënësve e kanë vlerësuar me 3, 11.3% e kanë vlerësuar me 4, dhe 36.9% prej tyre e kanë vlerësuar me 5.



6. A jeni të interesuar të bëni punë praktike?

Interes tjetër i këtij hulumtimi ishte edhe pjesa e interesimit të nxënësve për të mbajtur punë praktike. Prej totalit të 556 respondentëve, 87.9% prej tyre treguan se janë të interesuar, ndërsa vetëm 12.1% u shprehën se nuk janë të interesuar.

Shënim: Tek kjo pyetje, nëse përgjigja ishte po, ata do të vazhdonin t'u përgjigjeshin edhe pyetjes se pse janë të interesuar, ku si mundësi në përgjigje kishin 3 opionet: "për të marrë përvojë të re në profesionin që më intereson", "mund të fitoj një punë", "më pëlqen të sfidohem", "të njoh njerëz të rinjë" dhe opzioni "tjetër" ku mund të shkruanin ndonjë arsyet tjetër që ata ishin të interesuar për të mbajtur praktikë.



6.1 Nëse po, pse jeni të interesuar?


Në bazë të rezultateve, 52.2% u shprehën se atyre ju intereson të mbajnë punë praktike sepse marrin përvojë të re në profesionin që ata kanë interes, 22.5% prej tyre u shprehën se bëjnë punë praktike sepse mund të fitojnë një punë, 15.3% e tyre u shprehën se ju pëlqen të sfidohen dhe për këtë arsyе ju intereson të mbajnë punë praktike, ndërsa 9.2% e nxënësve vlerësuan se ju intereson puna praktike sepse njohin njerëz të rindë. Ndërsa, tek opzioni "tjetër", nxënësit dhanë disa arsyе tjera pse ju intereson të mbajnë punë praktike, disa prej përgjigjeve ishin: sepse ju ka interesuar gjithmonë profesioni i caktuar prej kur kanë qenë fëmijë, të dijnë rrëth profesionit që kanë zgjedhur, të jenë më të gatshëm për të ardhmen, dhe të provojnë profesione të ndryshme dhe të përshtaten në njërin prej tyre.



Pyetja 6.1.

7. A mendoni që puna praktike është e dobishme?


Një e gjetur tjetër me rëndësi është edhe për pjesën e përfitimeve nga puna praktike, do të thotë se a e shohin nxënësit punë praktike të dobishme. Nga analiza e rezultateve të gjithësëj 556 respondentëve, shihet se 95.1% e kanë vlerësuar si të dobishme punën praktike, kurse vetëm 4.9% e kanë vlerësuar si jo të dobishme.



Pyetja 7

7.1 Nëse po, pse?

Nga rezultatet shihet se në 42.3% të rasteve, nxënësit e kanë vlerësuar se puna praktike është e dobishme për t'u zhvilluar në profesionin që ju intereson, 28% e nxënësve e vlerësuan se është e dobishme sepse ngriten profesionalisht dhe 29.2% e tyre vlerësuan se është e nevojshme për t'a pasur më të lehtë punësimin pas shkollimit. Gjithashtu në këtë pyetje ka pasur mundësi që përpos përgjigjeve të lartpërmendura, të përgjigjen edhe vetvetiu, dhe përgjigja e një nxënësi ishte se e sheh të dobishme punën praktike sepse cdo eksperience e re është e dobishme për të.




Pyetja 7.1.

8. Sa do ishit i/e interesuar për të marrë pjesë në një program që lidh nxënësit e shkollave të mesme me bizneset lokale?


Një dimension me rëndësi i këtij hulumtimi është edhe interesimi i nxënësve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në një program që lidh nxënësit e shkollave të mesme me bizneset lokale, në mënyrë që ta kenë më të lehtë realizimin e punave praktike në lidhje me profesionet e tyre. Mundësitetë në përgjigje ishin nga 1 (Aspak i/e interesuar) deri në 5 (Shumë i/e interesuar). Nga 556 përgjigje, 7% e nxënësve u përgjigjen me 1, 3.8% e tyre u përgjigjen me 2, 18.2% e tyre u përgjigjen me 3, 17.3% u përgjigjen me 4, si dhe shumica prej tyre, 53.8% u përgjigjen me 5.

■ Pyetja 8




9. Në cilat drejtime do të ishit të orientuar për të bërë punë praktike?

Pikëpamje tjetër e fituar nga ky hulumtim është edhe orientimi i nxënësve për të bërë punë praktike. Rezultatet e fituara nga përgjigjet e nxënësve janë si në vijim. 46.6% prej tyre u përgjigjën në fushën e mjekësisë, 11.3% e nxënësve ishin të orientuar në juridik, 16.5% prej tyre ishin të interesuar në fushën e ekonomisë, 18.3% prej tyre kishin interes shkencat kompjuterike, 5% e nxënësve e vlerësuan PR dhe median digitale si të rëndësishme për ta, 5.6% prej tyre u përgjigjën për fushën e bujqësisë, 4.5% e nxënësve e vlerësuan hotelierinë si orientim për punë praktike, 3.8% e tyre vlerësuan makinerinë si fushë me interes për ta në lidhje me punën praktike, 1.6% e nxënësve cekën teknologjinë ushqimore. Kjo pyetje kishte gjithashtu edhe opsjonin për të shkruar fusha tjera përpos të lartpërmendurave. Ndërsa fushat e tjera të përmendura ishin edhe: muzika, edukimi, arti, dizajni, mekatronika, programimi, dizajn interior, konfeksioni, shkenca politike, psikologji, menaxhment, arkitekturë, dhe ndërtimitari.



10. Cfarë shihni si sfida të mundshme gjatë pjesëmarrjes në një program që bashkon shkollat e mesme me biznese?

Dimensioni i fundit sa i përket këtij hulumtimi, dhe poashtu e gjetur e rëndësishme është edhe pjesa se çka shohin si sfidë të mundshme gjatë pjesëmarrjes në një program që bashkon shkollat e mesme me biznese. Nga rezultatet e përgjigjieve të nxënësve mund të interpretohen këto të dhëna; 38.1% e tyre u përgjigjen me opsonin e mospërgatitjes profesionale të tyre, 29.3% e nxënësve e vlerësuan distancën/lokacionin si sfidë në bashkim, 34.5% e tyre interpretuan se kushtet e ofruara poashtu mund të jenë sfidë, 11.3% e nxënësve e vlerësuan diskriminimin gjinor si arsyje, 13.5% vlerësuan diskriminimin në bazë të moshave, 23.4% e nxënësve e vlerësuan se nuk ka ndonjë sfidë që ata mendojnë që mund të shfaqet gjatë pjesëmarrjes në një program që bashkon shkollat e mesme me biznese. Në këtë pyetje kishte edhe opson ku mund të shkruanin nxënësit ndonjë arsyje tjetër që ata e vlerësojnë se mund të jetë, ndër to janë edhe pabarazi në njerëz, aftësitë sociale të tyre, dhe të gjitha ngapak.



11. A keni ndonjë sugjerim apo ide se si mund të përmirsohet ky program?

Si formë konkludimi, u parashtrua pyetja se a kanë ndonjë sugjerim apo ide se si mund të përmirësohet ky program. Nga rezultatet mund të shihen disa përgjigje:

<p>“caktimin e vendeve të sakta për mundësi të praktikës”</p>	<p>“vendi i praktikave të jetë në përputhje me vendin ku jetojnë nxënsësit në mënyrë që të jenë më të qasshëm në vendet ku mbahet puna praktike”</p>	<p>“pjesëmarrja pa limit e vullnetarëve që mund të marrin pjesë në punë praktike pa pagesë”</p>	<p>“te dergohen me pak praktikante gjate një orari te caktuar pasi që rritet mundesia per te mesuar me shume gjera”</p>
	<p>“përmirësohet nëse të gjitha opsjonet e pyetjes më lartë kthehen në pozitive”</p>	<p>“angazhimin e mentorëve profesional në mbikqyrjen e nxënësve gjatë praktikës”</p>	
	<p>“ofrimin e një shume simbolike të pagesës gjatë punës praktike”</p>	<p>“të ketë më shumë biznese të përfshira në mundësi të praktikës”</p>	<p>“bashkëpunimi i duhur në mes institucioneve”</p>
<p>“të ofrohen mundësi bashkëpunimi tek të rinjtë në mënyrë që të mbahen edhe aktivitetë tjera ndihmuese për praktikë”</p>	<p>“investime më të shumëta në fushën e praktikës profesionale”</p> <p>“të ketë buxhet të mjaftueshëm për realizimin e praktikave nëpër institucionet të ndryshme”</p>	<p>“sigurimin e transportit pa pagesë nëpër vendet ku duhet të mbahet praktika e nxënësve”</p>	<p>“të ketë më shumë sesione informuese për vetëdijësimin e nxënësve në lidhje me rëndësinë e punës praktike”</p>
	<p>“inspektimin e praktikave që mbahen nga nxënësit në mënyrë që të rritet cilësia e mësimit”</p>	<p>“të ketë investime në mjete dhe kabinete në mënyrë që të rritet interesimi i nxënësve për praktikë”</p>	<p>“përmirësimin e kushteve teknologjike për nxënësit”</p>

Tabela nr. 1. Pyetësori i përdorur

1. Gjinia	2. Mosha	3. Klasa	4. Rajoni
5. A keni mbajtur ndonjëherë punë praktike?	Po	Jo	*Nëse zgjedhet opzioni (PO) si përgjigjje; atëher kalohet tek pyetja 5.1.
5.1 Ku e keni mbajtur këtë praktikë?	1 Muaj	5.2 Sa ka qenë kohëzgjatja e programit të praktikës?	
(P.sh. Institucion - Universiteti i Prishtines, Fakulteti Juridik ose Biznes - Salloni Auto-Mekanik "Naimi")	3 Muaj		6 Muaj
5.3 A ka qenë praktikë me pagesë?	Po		Jo
5.4 Sa jeni ndarë të kënaqur me këtë eksperiencë?		1) Aspak i/e kënaqur 3) Mesatarisht i/e kënaqur 5) Shumë i/e kënaqur 2) Deri diku i/e pakënaqur 4) Deri diku i/e kënaqur	
6. A jeni të interesuar të bëni punë praktike?	Po	Jo	*Nëse zgjedhet opzioni (PO) si përgjigjje; atëher kalohet tek pyetja 6.1.
6.1 Nëse po, pse jeni të interesuar?	Mund të fitoj një punë		Të njoh njerëz të rindë
Për të marrë përvojë të re në profesionin që më intereson	Më pëlqen të sfidohem		Tjetër
7. A mendoni që puna praktike është e dobishme?	Po	Jo	*Nëse zgjedhet opzioni (PO) si përgjigjje; atëher kalohet tek pyetja 7.1.

7.1 Nëse po, pse?	8. Sa do ishit i/e interesuar për të marrë pjesë në një program që lidh nxënsit e shkollave të mesme me bizneset lokale?		
Për t'u zhvilluar në profesionin që më intereson	1) Aspak i/e interesuar	2) Deri diku i/e painteresuar	
Për t'u ngritur profesionalisht	3) Mesatarisht i/e interesuar	4) Deri diku i/e interesuar	5) Shumë i/e interesuar
Për t'a pasur më lehtë të punësohem pas shkollimit	9. Në cilat drejtime do të ishit të orientuar për të bërë punë praktike?		
Tjetër	Mjekësi / Juridik	Ekonomik / Makineri	Shkenca kompjuterike
	PR dhe Media Digitale	Bujqësi / Hoteleri	Tjetër
10. Cfarë shihni si sfida të mundshme gjatë pjesëmarrjes në një program që bashkon shkollat e mesme me biznese?	Mospërgaditja profesionale	Lokacioni / Distanca	Diskriminimi në bazë të moshës
	Kushtet e ofruara	Diskriminimi gjinor	
	Tjetër	Nuk ka ndonjë sfidë	
11. A keni ndonjë sugjerim apo ide se si mund të përmirsohet ky program?			
Koment i hapur			

